

ARRITJA NË GJERMANI

Hapat e parë
pas hyrjes



Diakonie 
Deutschland

Arritja në Gjermani: hapat e parë pas hyrjes

Dëshironi ta përgatitni mirë shpërnguljen tuaj në Gjermani? Kur shpërnguleni në një vend tjetër, duhet të organizoni shumë gjëra dhe të respektoni kërkesat ligjore.

Kjo broshurë ju tregon se si të përgatiteni mirë. Ju mund të lexoni se çfarë duhet të organizoni dhe cilët hapa duhet t'i kryeni në Gjermani.

Ju urojmë shumë sukses në përgatitje dhe një fillim të mbarë në Gjermani!

Përgatitja dhe këshillimi në vendin tuaj

I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani –
Këshillim rreth migrimit para hyrjes (Diakonie)

Ekspertët ofrojnë këshillim individual në gjuhën tuaj për:

- Përgatitjen e integrimit në shoqëri dhe në tregun e punës
- Ndihmë për njohjen e kualifikimeve profesionale
- Integrimin e suksesshëm të familjes ose të fëmijëve në sistemin arsimor
- Sigurinë financiare/shëndetin
- Mbrojtjen nga ofertat jo serioze dhe lloje të tjera varësish

Për të gjitha pyetjet që lidhen me përgatitjen dhe me temat e kësaj broshure, mund të përfitoni nga ofertat e paraintegrimit në vendin tuaj.

Kontakttoni ekipin e projektit „I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani“ në: www.legal-migration.de/ko

Mbështetje dhe këshillim në Gjermani

Në Gjermani, për informacione dhe këshillim mund të kontaktoni: MBE – Këshillimi për migrim për të rritur të huaj (për persona mbi 28 vjeç, www.migrationsberatung.org) ose JMD – Shërbimet e migracionit për të rinjtë (për persona nga 12 deri në 27 vjeç, www.jugendmigrationsdienste.de).

Përmbledhje e shpejtë – prioritetet e para

- 1. Para hyrjes, nëse kërkohet për vizë:** hapja e një llogarie bankare dhe përfundimi i sigurimit shëndetësor, gjetja e banesës.
- 2. Dokumentet e rëndësishme merrni me vete dhe, për siguri, digjitalizoni:** dëftesën e shkollës, diplomën e shkollës profesionale ose të universitetit me pasqyrën e lëndëve dhe notave, dëftesat e punës, certifikatën e martesës, certifikatën e lindjes, certifikatën e bashkësisë familjare etj.
- 3. Menjëherë pas hyrjes:** blini internet/SIM-kartelë dhe nëse është e nevojshme gjeni strehim të përkohshëm.
- 4. Brenda 14 ditëve:** regjistrimi i banesës në Zyrën për Banim – e obligueshme.
- 5. 3–4 javët e para:** aplikimi për zgjatjen e lejes së qëndrimit, gjetja e një banese të përhershme nëse është e nevojshme, lidhja e internetit dhe përgatitja për fillimin e punës.
- 6. Fillimi në punë:** dorëzimi i numrit tatimor (Steuer-ID), kontrollimi i listës së pagës, qartësimi i lejes së punës dhe kualifikimeve nëse është e nevojshme.
- 7. Fillimi në jetën e përditshme:** hapja e një llogarie rrjedhëse (Girokonto) në Gjermani (nëse nuk është bërë ende), regjistrimi për kontributin e radio-televizionit (Rundfunkbeitrag), organizimi i kujdesit për fëmijë dhe shkollë.
- 8. Tatimet dhe financat:** kontrollimi i klasës së tatimit, përgatitja e deklaratës tatimore nëse është e nevojshme dhe përfundimi i sigurimeve.
- 9. Integrimi dhe formimi i mëtejshëm:** përdorimi i kurseve të gjermanishtes, rrjeteve lokale, shfrytëzoni shoqatat dhe mundësitë e zhvillimit profesional; përdorimi sa më herët i shërbimeve të këshillimit për migrim në vendbanimin e ri.

Interneti & Komunikimi



Wi-Fi falas

- **Aeroportet/Stacionet e trenave:** me kohë të kufizuar
- **Sheshet publike, restorantet dhe kafiteritë:**
Në shumë qytete ka hotspot-e publike të Wi-Fi-së.
- **Hotelet:** Wi-Fi në holl shpesh i qasshëm edhe për jo-mysafirë

Udhëzime sigurie

- Rrjetet publike WLAN janë të pambrojtura dhe të rrezikuara nga hakerët.
- Mos transmetoni të dhëna të ndjeshme (fjalëkalime, bankë).
- Përdorni VPN (Virtual Private Network) për mbrojtje të të dhënave.





SIM-kartelë gjermane (rekomandohet për internet të qëndrueshëm)

Kushtet

- Letërnjoftim / Pasaportë / Leje qëndrimi elektronik për identifikim
- Shpesh është e nevojshme një adresë gjermane si adresa për faturim.

Opsioni me parapagesë (disponueshmëri e menjëhershme)

- Nuk kërkohet kontroll kredibiliteti
- Çasje të menjëhershme në supermarkete, stacione karburanti dhe dyqane elektronike
- Përdorim fleksibil pa angazhime afatgjata
- Kërkohet legjitimim në vend, përmes identifikimit me video ose përmes postës
- **Ofruesit kryesorë:** Telekom, Vodafone, O2, Aldi Talk

Kontratë – Postpaid

- Tarifa më të lira, shpesh me Smartphone të subvencionuar
- Kërkohet kontroll kredibiliteti dhe llogari bankare gjermane
- E mundur vetëm pas regjistrimit dhe hapjes së llogarisë

KËSHILLË:

Filloni me parapagim për internet të menjëhershëm, dhe nëse është e nevojshme kaloni më vonë në Postpaid. Numri i telefonit mund të transferohet (me pagesë) në kontratën e re. Lexoni gjithmonë me kujdes kontratat, në mënyrë që të kuptoni të gjitha detajet, çmimet dhe kushtet.

Akomodimi & Transporti



Akomodim i përkohshëm dhe banim afatgjatë

- **Siguroni hotel/Airbnb/banesë pushimi** për ditët e para ose **WG** (bashkëjetesë) ose **qira e përkohshme** (afatshkurtër për një periudhë të caktuar)
- **Për studentët:** Regjistrimi në **AAA** (Zyra Akademike për Studentët Ndërkombëtarë) të universitetit përkatës për një dhomë në konvikt.



Transporti publik

Shkarkoni aplikacionet

- **DB Navigator** (transporti me distanca të gjata në të gjithë Gjermaninë dhe të gjitha lidhjet e transportit lokal): www.bahn.de
- **Aplikacionet lokale të transportit:** për shembull MVG (München), BVG (Berlin), VRR (NRW)

Blerja e biletës

- **Automatet për bileta** (shpesh në dispozicion edhe në anglisht dhe gjuhë të tjera)
- **Aplikacionet në Smartphone** (bileta digjitale)
- **Drejtëpërdrejt tek shoferi i autobusit** (vetëm herë pas here e mundur)



KËSHILLË:

Trenat ofrojnë **Deutschland-ticket** për 58 euro në muaj (Gjendja: shtator 2025) si abonim. Kjo biletë mund të përdoret për transportin publik lokal (autobusë, lidhje rajonale treni, tramvaje, metro) në gjithë Gjermaninë. Bëhet kontroll i kredibilitetit.

Rregullore të rëndësishme

- **Biletat e shtypura duhet të vulosen para nisjes:** ndonjëherë në platformë dhe jo brenda trenit ose autobusit, ndonjëherë mund të vulosen direkt në mjetet e transportit (varet nga rregullorja).
- Ka trena / autobusë në të cilët mund të hipni vetëm me biletë të vlefshme dhe ku nuk mund të blihet biletë.
- Nëse nuk keni mundur të blini biletë më parë, kërkoni menjëherë ndihmë nga stafi i trenit dhe shpjegoni problemin.
- Udhëtimi pa biletë kushton të paktën 60 euro. Udhëtimi pa biletë është vepër penale dhe mund të ketë pasoja për qëndrimin në rast të ndëshkimit penal.
- Kontrollat janë të shpeshta dhe të rrepta.



Shërbime taksish

- **Aplikacionet:** Uber, Bolt ose aplikacione lokale taksish
- **Telefon:** Numër kombëtar 22456 (përcjellje te qendra lokale)
- Përdorni vetëm taksi të licencuara (me shenjë taksie, taksimetër)

Ruani kontaktet e emergjencës



- **Policia:** 110
- **Zjarrfikësit/Shërbimi i shpëtimit:** 112 (mjek urgjent ose ambulancë, nëse duhet të veprohet shpejt, në rast aksidentesh ose sëmundjesh që rrezikojnë jetën.)
- **Shërbimi i mjekut në gatishmëri:** 116 117 (nëse ordinancat e mjekut familjarë janë të mbyllura dhe duhet të vizitoni mjekun; në rast urgjent, kërcënues për jetën: 112)
- **Punëdhënës/Departamenti i burimeve njerëzore**



Regjistrimi i vendbanimit (i obligueshëm brenda 14 ditëve)



Gjuha zyrtare në institucionet shtetërore, por edhe në shumicën e institucioneve, tek mjekët, bankat dhe kompanitë e sigurimeve, është gjermanishtja. Prandaj shpesh ju nevojiten dokumente në gjuhën gjermane ose një përkthim i vërtetuar i dokumenteve tuaja.

Krijoni një e-mail, sepse komunikimi përmes e-mail-it shpesh është i nevojshëm.

Ku: Zyra për qytetar (Bürgeramt) / Zyra e regjistrimit të vendbanimit tuaj

Dokumentet e domosdoshme

- Letërnjoftim ose pasaportë
- Certifikata nga pronari i banesës (mund të merret edhe nga Airbnb/banesë pushimi)
- Leja e qëndrimit/Viza
- Kontrata e qirasë ose konfirmimi i hyrjes në banesë

KËSHILLË:

- Aplikimet dhe caktimet e takimeve tek autoritetet për të huajt, shërbimi për qytetarët dhe zyra e regjistrimit bëhen online. Informohuni me kohë në faqen e internetit të autoritetit përkatës.
- Akomodimet e përkohshme (Airbnb / banesa pushimi) pranohen për regjistrim – adresa mund të ndryshohet më vonë.
- Konfirmimi i regjistrimit të vendbanimit (Meldebescheinigung) është i rëndësishëm për shumë hapa të tjerë (llogari bankare, leja e qëndrimit, sigurimi shëndetësor). Ruajeni mirë këtë dokument.

Hapja e një llogarie bankare



Një llogari bankare gjermane është e obligueshme për pagesën e pagës; shumë punëdhënës nuk pranojnë llogari të huaja. Prandaj është e rëndësishme që të hapni me kohë një llogari bankare gjermane.

Banka tradicionale (Sparkasse, Deutsche Bank, Commerzbank, Volksbank)

- Rrjeti më i madh i degëve për këshillim personal, ata njohin situatën lokale
- Kushtet më të mira për kredi/financim
- Shpesh hapje llogarie më e ngadaltë

Bankat – online (N26, DKB, ING)

- Hapje më e shpejtë e llogarisë në mënyrë digjitale
- Tarifa më të ulëta
- Shërbime të kufizuara në degë

Dokumentet e nevojshme

- Pasaportë/Letërnjoftim
- Leja e qëndrimit
- Konfirmimi i regjistrimit të vendbanimit
- Kontrata e punës/Dëshmia e pagës
- Identifikimi përmes videos ose takim në degë



© Exclusive-Lab / istockphoto.com

Të vendosësh emrin në kutinë postare. Të regjistrohesh për pagesën e radios/televizionit



- **Menjëherë pas vendosjes:** Emrin dhe mbiemrin t'i vendosni qartë e të lexueshëm në kutinë postare.
- **Vërejtje:** Pa emër në kuti, posta nga institucionet nuk dorëzohet.
- **Kujdes me letrat në zarfe gri-verdhë:** Zakonisht janë letra të rëndësishme, zyrtare me afate. Këto letra duhet hapur menjëherë. Nëse është e nevojshme, kontaktoni një zyrë këshillimi (p.sh. këshillim për migracion).
- **Regjistrimi për kontributin e radios dhe televizionit publik** (Rundfunkbeitrag – pagesë e detyrueshme): www.rundfunkbeitrag.de



Sigurimet



Sigurimi shëndetësor duhet të jetë i vlefshëm që nga dita e parë e punës; idealisht, duhet ta rregulloni atë edhe para udhëtimit.

Sigurimi shëndetësor

Sigurimi shëndetësor ligjor (GKV)

- Sigurim i detyrueshëm për të ardhurat deri në 73.800 euro në vit (Gjendja: 2025)
- Punëdhënësi paguan 50 përqind të kontributeve.
- Anëtarët e familjes janë automatikisht të mbuluar, nëse i përfshini ata në sigurim (merrni një sigurim familjar).
- Mund të zgjidhni vetë sigurimin shëndetësor. Shërbimet bazë janë të përcaktuara me ligj.
- **E rëndësishme:** Sigurimi privat shtesë për udhëtime jashtë Bashkimit Evropian (shumë i lirë, rreth 15–20 euro në vit).

Sigurim shëndetësor privat

- Mund të zgjidhet për të ardhura mbi 73.800 euro në vit ose për të vetëpunësuarit
- Shpesh ofron shërbime më të gjera
- Përgjegjësi dhe kosto më të larta personale
- Kthimi tek sigurimi ligjor (GKV) më vonë është shumë i vështirë
- Nuk ka mbulim falas për anëtarët e familjes



Sigurime të tjera të rëndësishme



Sigurimi i përgjegjësisë civile (i rekomanduar dhe shpesh kërkohet nga pronarët e banesave)

- **Mbulim për:** dëmet që i shkaktoni personave të tjerë ose pronës së tyre
- **Kosto:** Rreth 50–80 euro në vit
- **E rëndësishme:** Në Gjermani dëmet nga përgjegjësia civile mund të jenë shumë të shtrenjta.
- Pa sigurim rrezikoni përgjegjësi personale
- **Check24** (www.check24.de) për hulumtime dhe krahasime



Sigurimi i pronës së banesës (për banesën tuaj)

- **Mbulim:** i dëmit nga vjedhjet dhe dëmtimet nga zjarri, uji dhe stuhitë.
- I dobishëm pas vendosjes në një banesë të përhershme
- **Kosto:** varet nga madhësia e banesës dhe vlera e mobiljeve/sendeve

KËSHILLË:

Sigurimi i përgjegjësisë civile duhet të nënshkruhet menjëherë pas mbërritjes; është një nga sigurimet më të rëndësishme në Gjermani dhe shumë i lirë.

Të aplikosh për leje qëndrimi ose vazhdimin e saj



Institucioni përgjegjës: Zyra për të huaj në vendbanimin tuaj

Dokumentet e domosdoshme

- Formularët e aplikimit (online ose në zyrë)
- Fotografi pasaporte biometrike
- Kontrata e punës & dëshmitë e kualifikimeve
- Vërtetimi i banimit & dëshmia e sigurimit shëndetësor
- Paraprakisht kontrolloni në faqen zyrtare se cilat dokumente nevojiten në rastin tuaj

E rëndësishme: Takimet duhen caktuar paraprakisht online ose me telefon

KËSHILLA:

1. Gjithmonë aplikoni për vazhdimin e lejes së qëndrimit me kohë para skadimit (përndryshe mund të ndodhë që ju duhet të ktheheni dhe të aplikoni për vizë të re. Kjo do të thotë që nuk do të keni qëndrim të ligjshëm pa ndërprerje. Ruani dëshmitë për aplikimin e bërë me kohë për zgjatjen e lejes së qëndrimit).
2. Kontrolloni rregullisht online statusin e aplikimit
3. Dërgoni email-e ri-kujtuse të sjellshme në rast të mungesës së një përgjigjeje
4. Telefononi për të pyetur në rast të mungesës së një përgjigjeje
5. Regjistroni marrëveshjet telefonike dhe ruani email-et afatgjatë
6. Pyetni për takime emergjente
7. Sa më shpejt të jetë e mundur aplikoni për të drejtë qëndrimi të përhershme (leje për qëndrim të përhershëm, Niederlassungserlaubnis) ose për shtetësi.
8. Kërkoni mbështetje nga zyra për këshillim për migracionin në vend ose nga punëdhënësi

Banimi dhe Interneti



Kërkimi i banesës

Portale online

- [ImmobilienScout24](#), [Immowelt](#) (portalet kryesore)
- [WG-Gesucht](#) (Dhoma në banesa të përbashkëta dhe apartamente të vogla)
- [Kleinanzeigen](#) (Kujdes nga mashtrimet/skemat mashtruese)
- Regjistrimi tek shoqata e ndërtimit të banesave në vendbanimin tuaj të ri – këtu zakonisht ka qira më të lira

Opsione Offline

- Gazeta lokale me seksionin e pasurive të paluajtshme
- Agjentët e pasurive të paluajtshme në vendbanim
- Rrjeti përmes punëdhënësit dhe kolegëve

Në disa raste, mund të aplikoni për një certifikatë të së drejtës për banim (WBS) për banesa të subvencionuara nga shteti. Informohuni për këtë te zyra lokale e banesave.



Lidhja me internet për shtëpi

- **Ofruesit kryesor:** Deutsche Telekom, Vodafone, 1&1, O2
- Instalimi mund të zgjasë 2–6 javë
- **Zgjidhje e përkohshme:** Internet i lëvizshëm përmes SIM-it

Fillimi në profesion



- **Të komunikoni të dhënat e llogarisë bankare tek punëdhënësi**
- **Numri i sigurimeve shoqërore:** Jepet automatikisht nga sigurimi i pensionit në fillim të punës.
- **Përcaktimi i klasës së tatimit mbi pagën:** zakonisht Klasa I për të pa martuarit, Klasa III/V ose IV/IV për të martuarit
- **Finalizimi i kontratës së punës:** kontrolloni të gjitha detajet dhe nënshkruani
- Dorëzimi i **lejes së punës** tek punëdhënësi

Njohja profesionale (nëse është e nevojshme)

PROCEDURA HAP-PAS-HAPI

- 1. Këshillim nga zyra e njohjes profesionale:** Në secilin rast mund të jetë shumë e ndryshme se cili aplikim është i përshtatshëm dhe çfarë duhet të merret parasysh. Prandaj, këshillimi individual është i rëndësishëm
- 2. Bëni aplikimin online:** Gjeni rrugën e duhur të njohjes në faqen kryesore të internetit.
- 3. Përgatitni dokumentet:** Dëshmi shkollore, përkthime të legalizuara, dëshmi të trajnimeve ose kualifikimeve
- 4. Dorëzoni aplikimin: Tek autoriteti përgjegjës (varet nga profesioni).**
- 5. Prisni vendimin:** Mund të zgjasë 3–6 muaj
- 6. Në rast njohjeje të pjesshme:** Mund të nevojiten kualifikime të mëtejshme ose masa përshtatjeje

DALLIM I RËNDËSISHËM

Profesione të rregulluara: Njohja është e detyrueshme për ushtrimin e profesionit.

- Shembuj: Mjek / Mjeke, Farmacist/e, Avokat/Avokate, Inxhinier/e, Mësues/e

Profesione jo të rregulluara: Njohja është vullnetare, por e rekomanduar për mundësi më të mira pune.

- Shembuj: Specialist/e i IT-së, Ekonomist/e, Grafik/e, Zejtar/e



Beratung und Unterstützung

- **Këshillim dhe përkrahje**
www.make-it-in-germany.com
- **ëshillim për njohjen profesionale:**
www.anerkennung-in-deutschland.de
dhe ProRecognition www.anerkennung-in-deutschland.de/html/de/pro/prorecognition.php
si dhe për kualifikimet arsimore www.anabin.de
- **Qendra kryesore e shërbimit për njohjen e profesionit** www.arbeitsagentur.de/fuer-menschen-aus-dem-ausland
- **IHK (Oda e Industrisë dhe Tregtisë):** për profesionet tregtare dhe teknike www.ihk.de
- **Dhoma e Artizanatit** për të gjitha profesionet e Zejtarisë www.handwerkskammer.de
- **Welcome Center:** Shumë qytete/rajonë kanë pika të veçanta kontakti www.make-it-in-germany.com/de/service/beratung-anlaufstellen/in-deutschland

Taksat & Financat



- **ID tatimore:** jepet automatikisht dhe duhet t'i përcillet punëdhënësit
- **Klasa e tatimit mbi pagën:** varet nga gjendja familjare, mund të ndryshohet edhe online
- **Deklarata tatimore:** shpesh është e mundur të merret rimbursim, veçanërisht në vitin e parë dhe është veçanërisht e rëndësishme për çiftet e martuara dhe familjet me fëmijë
- **Këshillim në vend nga shoqatat e ndihmës për tatimin mbi pagën:** www.bvl-verband.de

Për specialistët dhe punëtorët ndërkombëtarë

- Kujdes me **marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë** mes Gjermanisë dhe vendit të origjinës
- **Këshillimi tatimor** rekomandohet në situata më komplekse ndërkombëtare



KËSHILLË:

Këshillohuni me zyrën tatimore përkatëse. Ndihmë mund të merrni nga shoqatat e ndihmës për tatimin mbi pagën (anëtarësimi shpesh është shumë i lirë) ose nga këshilltarët tatimorë, të cilët duhet t'i paguani vetë.

Integrimi & Avancim i mëtejshëm



Njohuritë e gjuhës gjermane

- Instituti Goethe ofron, përveç kurseve klasike të gjuhës në institucion, edhe opsione online: www.goethe.de/de/spr/ueb.html, [Mein Weg nach Deutschland](http://MeinWeg.nach.Deutschland)
- Kurset e integrimit dhe orientimit (tek BAMF: për shumë persona janë të obligueshëm dhe financohen pjesërisht): bamf-navi.bamf.de/de
- Ka kurse të gjermanishtes të lidhura me profesionin, të veçanta për specialistët.
- **Platformat online:** Babbel, Duolingo, Deutsche Welle (learngerman.dw.com/de/deutsch-lernen/s-9095)
- Qendër e arsimit të të rriturve (VHS) në vendbanim www.volkshochschule.de



Integrimi social

- Shoqatat lokale (Sport, Muzikë, Hobit, Aktivitetet vullnetare), Shkollat e qytetit (VHS)
- Organizatat e migrantëve dhe diasporës dhe grupet ndërkombëtare
- Për shembull: www.bundeskonferenz-mo.de
www.damigra.de
www.bv-nemo.de
- Programet komunale të integrimit dhe Welcome Center www.make-it-in-germany.com/de/service/beratung-anlaufstellen/in-deutschland
- Këshillim për migracion në vendbanim www.migrationsberatung.org
- Shërbimi i migracionit për të rinjtë nën moshën 27 vjeçare www.jugendmigrationsdienste.de

Lista e gjërave që duhet bërë

Java 1: Masat e menjëhershme & Përgatitja

- Të merret një SIM-kartelë për internet dhe telefonata
- Të sigurohet një vendbanim i përkohshëm (nëse nuk është bërë ende)
- Regjistrimi i banesës në Zyrën e Qytetarëve (e obligueshme brenda 14 ditëve)
- Hapja e një llogarie bankare për pagesën e rrogës

Java 2: Procedurat me institucionet shtetërore

- Të bëhet sigurimi shëndetësor (shtetëror ose privat)
- Të vendoset emri në zile dhe në kutinë postare
- Të pritët Numri i Identifikimit Tatimor (Steuer-ID) dhe t'i përcillet punëdhënësit

Java 3: Përgatitja për fillimin e punës & Sqarimi i situatës së banimit

- Të kërkohet një banesë e përhershme (nëse jeni ende në vendbanim të përkohshëm)
- Të aplikohet për lidhjen e internetit në banesën e përhershme
- Të dërgohen të dhënat bankare te punëdhënësi
- Të kontrollohet kontrata e punës dhe, nëse është nevoja, të nënshkruhet
- Të aplikohet për leje qëndrim (të caktohet takim)

Java 4: Fillimi i punës & përshtatja/integrimi

- Fillimi i punës
- Të kontrollohet dhe kuptohet fletëpagesa e parë
- Të përfundohet procesi i njohjes së kualifikimeve (nëse ende nuk është kryer)
- Të bëhet regjistrimi dhe fillimi i kursit të gjermanishtes
- Të kontrollohen dhe të mbyllen sigurimet (p.sh. sigurimi i përgjegjësisë, i banesës, etj.)
- Të njihet shërbimi lokal dhe infrastruktura
- Kontakt i hershëm me shërbimin e këshillimit për migracionin në vend, nëse ka nevojë për këshillim

Të dhënat e botuesit

Publikuesi:

Diakonie Deutschland

Evangelisches Werk für Diakonie
und Entwicklung e. V.

Caroline-Michaelis-Straße 1

10115 Berlin

T +49 30 652 11-0

F +49 30 652 11-3333

diakonie@diakonie.de

www.diakonie.de

Kontakti:

Maja Kliem

Projekt Internationale Migrationssozialarbeit

Zentrum Flucht und Migration

T +49 30 652 11-1457

Maja.kliem@diakonie.de

imsa@diakonie.de

Konceptimi dhe teksti:

Maja Kliem, Maria Shmarova

Bashkëpunim në përmbajtje:

Jeannette Bell, Jürgen Blechinger, Emeka Bob-Anyeji, Isabelle Schunck

Përkthimi:

Ardiana Shala, Furtuna Shabani Shala

Lekturimi:

Emeka Bob-Anyeji

Redaktimi:

Sarah Spitzer

Dizajn:

Bianca Werninghaus

Botim:

Shtator 2025

With funding from the



Federal Ministry
of the Interior

With funding from:



Federal Government Commissioner
for Migration, Refugees and Integration
Federal Government Commissioner for Anti-Racism

by decision of the
German Bundestag



Co-funded by
the European Union



Baden-Württemberg
Ministry of Social Affairs,
Health and Integration

Funded by state funds approved by the state
parliament of Baden-Württemberg.

Diakonie

Përgjegjës për projektin:

Diakonisches Werk Baden në partneritet me Diakonie në Württemberg.

Bashkëpunimi me Diakonie Deutschland, Diakonie Hamburg, APPK, International Studies Institute (ISI) (Kosovë/Shqipëri), Caritas Maqedoni e Veriut, SABEV (Turqi), Faros (Bosnjë-Hercegovinë), EHO-Ecumenical Humanitarian Organisation (Serbi), Caritas Ukrainë, Diakonie Gjeorgji (Gjeorgji/Armeni), Goethe-Instituten në Etiopi, Marok dhe Nigeri, si dhe me Shoqatat e Diakoni-së të landeve Bavari, Bremen, Hessen, Mecklenburg-Vorpommern, Mitteldeutschland, Niedersachsen, Pfalz, Rheinland-Westfalen-Lippe, Berlin-Brandenburg-Schlesische Oberlausitz, Sachsen, Schleswig-Holstein.

Projekti financohet nga Fondi Evropian për Azili, Migracion dhe Integrim (AMIF), Republika Federale e Gjermanisë (Komisioneri i Qeverisë Federale për Migracion, Refugjatë dhe Integrim, Komisioneri i Qeverisë Federale për Anti-Racizem dhe Zyra Federale për Migracion dhe Refugjatë – BAMF), si dhe nga landi i Baden-Württemberg dhe Diakonie.